



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova



KOSOVA DEVELOPMENT CENTER
QENDRA KOSOVARË PËR ZHVILLIM
Address: Dëshmorët e Lirisë nr.135 Gjakovë-Kosovë
Tel: +383 38 724-499 Email: kdc.kosovo@yahoo.com
www.kdc-ks.org

Menaxhimi i Bletës për prodhim të qëndrueshëm



Hyrje

Bletaria është një veprimtari bujqësore dhe ekologjike me rëndësi të madhe për biodiversitetin dhe prodhimin bujqësor. Ajo përfshin rritjen dhe kujdesin për bletët me qëllim të prodhimit të mjaltit, dyllit, propolisit, polenit dhe të tjerave produkte të bletës, si dhe shërbimin e pllenimit për bimët bujqësore. Bletaria ka një ndikim të shumëfishtë në ekonomi dhe mjedis:

Prodhimi i produkteve bletare - Mjalti, dylli, propolisi, poleni dhe qumështi i bletës kanë përdorime të shumta në industrinë ushqimore, farmaceutike dhe kozmetike.

Pllenosja e bimëve - Bletët ndihmojnë në përmirësimin e rendimentit të kulturave bujqësore përmes pllenimit natyror, duke rritur produktivitetin dhe cilësinë e frutave dhe perimeve.

Ruajtja e biodiversitetit - Bletët janë pjesë e rëndësishme e ekosistemit dhe ndihmojnë në ruajtjen e florës natyrore.



Foto 1: Bleta prezentë në Kosovë

Zgjidhni vendndodhje të përshtatshme për blete, larg ndotjes dhe pesticideve për prodhim cilësorë

Menaxhimi i bletëve

Është një proces i ndërlikuar që kërkon njohuri dhe kujdes të vazhdueshëm për të siguruar prodhim të qëndrueshëm të mjaltit, dyllit, polenit, propolisit dhe produkteve të tjera të bletarisë. Për të arritur një prodhim të qëndrueshëm, duhet të merren parasysh faktorët biologjikë të bletëve, kushtet mjedisore dhe praktikatat e duhura të menaxhimit.



Foto 2: Cikli i zhvillimit të bletës

Siguroni larmi bimore për kullotë të bollshme dhe cilësore për zhvillimin dhe menaxhimin e bletës së qëndrueshme

** Bimët dhe lulet më të rëndësishme për bletët në Pranverë (mars-maj)**

Bima/Lulja	Lloji i burimit	Koment
Lulëzimet e hareshme në pyje	Polen	E rëndësishme për zhvillimin fillestar
Dardha, molla, qershia, kumbulla etj.	Polen + nektar	Pëllëmborë pjalmohen nga bletët
Lulja e boronicës, dredhëzat, mjedrës, manaferrës etj.	Nektar + polen	Bimë pyjore me vlerë për mjaltë
Trëndafili i egër ne fusha dhe pyje	Nektar + pak polen	Tërheqëse për bletët

Sqarim: Këto bimë ndihmojnë në zhvillimin e hershëm të familjes së bletëve

** Bimët dhe lulet më të rëndësishme për bletët në Verë (qershor-gusht).**

Bima/Lulja	Lloji i burimit	Koment
Bliri (Lipa)	Nektar + polen	Jep mjaltë të çmuar aromatik
Lulja e jonxhës	Nektar + polen	Një nga bimët më të vlefshme për bletët
Luledielli	Polen + nektar	Jep polen të bollshëm, më pak nektar
Sherebela	Nektar	Bimë mjekësore shumë e dashur nga bletët
Lulja e livandës	Nektar + polen	Aromatike, ndihmon edhe në pastrimin e kosheres
Lulet e livadheve	Polen	I rëndësishëm për zhvillimin e bletëve

Sqarim: Sezoni kryesor i grumbullimit të mjaltit

** Bimët dhe lulet më të rëndësishme për bletët në Vjeshtë (shtator-tetor) :-**

Bima/Lulja	Lloji i burimit	Koment
Bima e lulediellit të vonë	Nektar + polen	Mbështetje për bletët në fund të sezonit
Lulja e ndryshme në pyje dhe livadhe	Nektar	Stimulon sistemin imunitar të bletëve
Gështenja	Nektar + polen	Jep mjaltë të errët me shije të fortë

Sqarim: Periudha e përgatitjes për dimër

 Bimë mjekësore dhe aromatike të favorshme për bletët janë të shkëlqyera për mjaltë cilësor dhe shëndetin e bletëve. Këto bimë janë: Rigoni, Trumza, Rozmarina, Menta (nenexhiku), Kamomili, Boronica, Lavanda, Sherebela.

Këshilla për bletarët dhe fermerët:

- ✓ Mbillni bimë të ndryshme që lulëzojnë në periudha të ndryshme për të siguruar ushqim të vazhdueshëm.
- ✓ Evito përdorimin e **pesticideve** gjatë lulëzimit, pasi dëmtojnë bletët.
- ✓ Mbillni **jonxhë, livadhe, sherebelë dhe lule të egra** në afërsi të koshereve.

Këshilla të rëndësishme për fermerët për të mbrojtur bletët dhe për të bashkëjetuar me bletarinë:

- ✓ Evito përdorimin e pesticideve gjatë lulëzimit, pasi ato dëmtojnë direkt bletët përmes nektarit dhe polenit të kontaminuar. Përdorimi i kimikateve në këtë periudhë mund të shkaktojë vdekje masive të bletëve dhe ndotje të mjaltit.
- ✓ Spërkatja duhet të jenë larg koshereve dhe blertëve.
- ✓ Spërkat në orët e vona të pasdites ose në mbrëmje, kur bletët janë kthyer në kosheret e tyre. Kjo redukton rrezikun e kontaktit direkt me pesticidet.
- ✓ Njofto bletarët lokalë para spërkatjes - bashkëpunimi me bletarët ndihmon që ata të marrin masa mbrojtëse, siç është mbyllja e koshereve ose zhvendosja e tyre përkohësisht.
- ✓ Përdor produkte biologjike ose të lejuara për bujqësi të integruar, të cilat janë më të sigurta për insektet e dobishme dhe që janë pa padëmshme për bletët.
- ✓ Mbillni bimë mellifere (që prodhojnë nektar) pranë arave, si jonxhë, luledielli, livadheve, sherebelë etj. Kjo ndihmon jo vetëm bletët, por edhe rrit rendimentin e kulturave përmes pjalmimit më të mirë.
- ✓ Mos spërkat gjatë periudhës së erës, sepse pesticidet mund të përhapen edhe në zona përreth, duke ndotur lulet dhe barin në afërsi të koshereve.
- ✓ Edukimi i fermerëve dhe punëtorëve bujqësorë rreth ndikimit të kimikateve në shëndetin e ekosistemit është kyç për mbrojtjen afatgjatë të bletëve.

Elementët kryesorë të menaxhimit të bletëve për prodhim të qëndrueshëm janë:

1. Zgjedhja e racës së bletëve (1.1. Raca duhet të jetë e përshtatshme për klimën dhe kushtet e rajonit; 1.2. Raca autoktone shpesh është më rezistente ndaj sëmundjeve dhe kushteve klimatike lokale; 1.3. Raca si *Apis mellifera carnica* dhe *Apis mellifera caucasica* janë të njohura për sjellje të butë dhe prodhim të mirë të mjaltit).

2. Kujdesi për shoqëritë e bletëve (2.1. Monitorimi i rregullt i shoqërive për shëndetin e tyre; 2.2. Përdorimi i teknologjive të reja si peshorja digjitale për të përcjellë gjendjen e koshereve; 2.3. Mbajtja e një raporti të mirë mes bletëve punëtore dhe mbretëreshës për zhvillim optimal).

3. Ushqyerja e bletëve (3.1. Ofrimi i burimeve natyrore të nektarit dhe polenit nga bimët mjaltëdhënëse; 3.2. Mbjellja e bimëve mjaltëdhënëse si livanda, trumza, luledielli dhe akacia; 3.3. Sigurimi i ushqimit shtesë në periudhat e thata ose gjatë dimrit për të shmangur stresin ushqimor).

4. Kontrolli dhe parandalimi i sëmundjeve (4.1. Monitorimi i rregullt i sëmundjeve si *Varroa destructor*, *Nosema* dhe bakteriozat; 4.2. Përdorimi i metodave biologjike dhe natyrore për kontrollin e parazitëve; 4.3. Mirëmbajtja e higjienës së koshereve për të parandaluar përhapjen e infeksioneve).

5. Menaxhimi i mbretëreshës dhe shumimi i shoqërive (5.1. Zëvendësimi periodik i mbretëreshës për të ruajtur produktivitetin e shoqërisë; 5.2. Përdorimi i teknikave të shumimit si ndarja natyrale ose artificiale e shoqërive për të ruajtur ekuilibrin).

6. Qasja ekologjike dhe praktikat e qëndrueshme (6.1. Shmangia e përdorimit të pesticideve dhe kimikateve që mund të dëmtojnë bletët; 6.2. Përdorimi i materialeve të riciklueshme dhe

natyrore për ndërtimin e koshereve; 6.3. Ruajtja e biodiversitetit për të siguruar burime të vazhdueshme të ushqimit për bletët).

7. Prodhimi dhe tregtimi i qëndrueshëm i mjaltit (7.1. Nxjerrja e mjaltit në periudha të përshtatshme për të mos dëmtuar shoqëritë e bletëve; 7.2. Certifikimi i mjaltit si produkt organik për vlerë më të lartë në treg; 7.3. Diversifikimi i produkteve të bletarisë për të siguruar të ardhura të qëndrueshme (mjalti, poleni, propolisi, dylli etj.).

Pajisjet e nevojshme në bletari

Këto pajisje janë thelbësore për të filluar një bletari dhe për të siguruar një menaxhim efikas të saj. Për të filluar dhe menaxhuar një bletari me sukses, është e rëndësishme të keni pajisjet e duhura. Pajisjet bazë ndihmojnë në mbrojtjen e bletëve, sigurinë e bletarit dhe rritjen e efikasitetit në mbledhjen e produkteve bletare janë:

1. Kosheret (Strofullat e Bletëve) - Kosheret janë shtëpitë ku jetojnë dhe punojnë bletët. Ato mund të jenë të llojeve të ndryshme: **Koshere Langstroth** - Më e përdorura në botë, e ndërtuar me korniza të lëvizshme. **Koshere Dadant** - E ngjashme me Langstroth, por me korniza më të mëdha për rritje më të madhe të kolonisë. **Koshere tradicionale** - Të ndërtuara nga druri ose kashta, përdoren në disa zona rurale.



Foto 3: Kosheret Langstroth dhe Dadant dhe Tradicionale

2. Kornizat dhe bazat e dyllit - **Kornizat**, janë struktura të vendosura brenda koshereve ku bletët ndërtojnë huallin e tyre. **Bazat e dyllit**, apo fleta të holla dylli që ndihmojnë bletët të ndërtojnë huallin më shpejt dhe në mënyrë më të organizuar.

3. Veshjet mbrojtëse për bletarin - **Kostumi i bletarit**, një veshje e plotë për mbrojtje nga thumbimet. **Dorëzat**, mbajnë duart të mbrojtura gjatë punës me kosheret. **Maska dhe kapuçi**, mbrojnë fytyrën dhe kokën nga thumbimet e bletëve.

4. Pajisjet për punën me bletët - **Djegësi i tymit** (smokeri), përdoret për të qetësuar bletët gjatë kontrollimit të koshereve. **Sfungjeri ose furça e bletarit**, përdoret për të larguar bletët nga hualli pa i dëmtuar. **Levera bletarie**, një mjet metalik që ndihmon në hapjen e koshereve dhe ndarjen e kornizave.

5. Pajisjet për mbledhjen dhe përpunimin e mjaltit - **Mjaltë mbledhësi** (centrifuga e mjaltit), një pajisje që ndihmon në nxjerrjen e mjaltit nga kornizat. **Filtrat e mjaltit**, përdoren për pastrimin e mjaltit nga papastërtitë dhe dylli. **Enët e depozitimit**, fuçi ose kavanoza për ruajtjen e mjaltit pas përpunimit.

6. Pajisjet për kujdesin ndaj Bletëve - Ushqyesit e bletëve, përdoren për të ushqyer bletët gjatë dimrit ose periudhave të vështira. **Medikamentet dhe suplementet**, për mbrojtjen e bletëve nga sëmundjet si varroa, nosema dhe sëmundjet bakteriale.

7. Pajisjet për prodhimin e produkteve shtesë - Shkrirësi i dyllit, përdoret për shkrirjen dhe pastrimin e dyllit të bletëve. **Pajisjet për prodhimin e propolisit dhe polenit**, përdoren për mbledhjen dhe përpunimin e këtyre produkteve të vlefshme.

Përgatitja e bletëve për sezonin e pranverës

Pranvera është një nga sezonet më të rëndësishme për bletarinë, pasi kolonitë fillojnë të zhvillohen pas dimrit dhe përgatiten për një sezon të ri prodhimi. Menaxhimi i duhur në këtë periudhë siguron një fillim të shëndetshëm për bletët dhe rrit prodhimin e mjaltit dhe behet:

1. Kontrollimi i hershëm i koshereve, koha e duhur - kontrollimi i parë bëhet sapo temperaturat të kalojnë 12-15°C, zakonisht në mars ose prill. Çfarë duhet kontrolluar? Numri i bletëve - Kolonia duhet të jetë e fortë dhe aktive. Prania e mbretëreshës - Shiko për vezë dhe larva të reja. Sasia e ushqimit - Sigurohu që ka mjaltë dhe polen të mjaftueshëm. Shëndeti i kolonisë - Kontrolllo për shenja të sëmundjeve. Gjendja e huallit - Zëvendëso kornizat e dëmtuara ose të vjetra.

2. Shtimi i ushqimit (nëse është e nevojshme) - Nëse rezervat e mjaltit janë të pakta pas dimrit, duhet të ushqesh bletët për të shmangur urinë. Llojet e ushqimit pranveror janë: Mjalti i ruajtur - Opsioni më i mirë dhe natyral. Shurupi i sheqerit (**ujë + sheqer**) - Stimulon zhvillimin e kolonisë. Peta proteinike (me polen ose sojë) - Ndihmon zhvillimin e larvave.

3. Kontrolli dhe luftimi i Varroas - Pas dimrit, popullata e bletëve është më e vogël, ndaj është momenti më i mirë për të trajtuar Varroan. Metodat e trajtimit: Acidi oksalik - Efektiv kundër Varroas, aplikohet në ditët e ftohta të pranverës. Acidi formik - Përdoret në temperatura mbi 10°C. Bletë rezistente ndaj Varroas - Një strategji afatgjatë për zvogëlimin e dëmtimeve.

Përgatitja e bletëve për sezonin e dimrit

Dimri është një periudhë kritike për bletët, pasi kushtet e ftohta, mungesa e nektarit dhe reduktimi i aktivitetit mund të çojnë në vdekshmëri të lartë nëse nuk bëhet përgatitja e duhur. Menaxhimi i kujdesshëm gjatë vjeshtës dhe dimrit siguron mbijetesën dhe fuqinë e kolonisë për pranverën e ardhshme.

Kontrollimi i kosheres në vjeshtë

Kontrolli i fundit i plotë i bletëve bëhet në shtator-tetor, kur temperaturat janë ende mbi 15°C. Pas kësaj, inspektimet duhet të jenë minimale për të mos shqetësuar koloninë.

Çfarë duhet kontrolluar?

1. Prania e mbretëreshës - A është aktive dhe duke pjellë vezë? Forca e kolonisë - A ka numër të mjaftueshëm bletësh? Sasia e ushqimit - A kanë mjaftueshëm mjaltë për dimër? Dëmtuesit dhe sëmundjet - A ka shenja të varroas, nosemas apo sëmundjeve të tjera?.

2. Sigurimi i ushqimit të mjaftueshëm - Një koloni duhet të ketë 20-30 kg mjaltë për të mbijetuar gjatë dimrit. Nëse nuk kanë rezervë të mjaftueshme, bletët mund të ushqehen me shurup sheqeri (sheqer + ujë) ose petë proteinike.

3. **Izolimi i kosheres për mbrojtje nga i ftohti** - Bletët mund të mbijetojnë në temperatura të ulëta, por problemi kryesor është lagështia dhe era. Lagështia e tepërt brenda kosheres mund të shkaktojë mushkërim dhe rritje të sëmundjeve.

Llojet e ushqimit plotësues për dimër:

1. **Shurupi i sheqerit (vjeshtë – gusht/shtator).** Përgatitet sheqer dhe ujë, për të stimuluar grumbullimin dhe dehidratimin e shpejtë. **Receta:** 2 kg sheqer + 1 litër ujë i nxehtë. Jepet i ngrohet, kushte shtëpiake dhe vendoset para hyrjes së kosheres, jo e thelluar afërsisht 0.5 cm.

2. **Brumi i sheqerit.** Jepet në **dimër**, kur temperaturat janë shumë të ulëta dhe bletët nuk dalin nga vatra. **Receta bazë:** 5 kg sheqer, 1 litër ujë, Opsionale: pak mjaltë i pastër ose vitaminë për bletë. Brumi vendoset mbi kornizat e koshereve në një enë plastike ose në letër furre të ngjitur me vrime.

3. **Ushqim proteinik (torta me polen artificial).** Jepet në vjeshtë për të forcuar bletët dimërore (nuk rekomandohet në mes të dimrit). Përmban: pluhur soje, maja birre, polen të thatë ose zëvendësues, vitamina për bletë.

Kujdesi dhe menaxhimi i bletëve

Për të pasur një bletari të suksesshme, është e rëndësishme të ndjekësh praktika të mira të menaxhimit dhe të kujdesesh për bletët në mënyrë të vazhdueshme. Kjo përfshin:

1. Kontrollimin e rregullt të koshereve

(Kontrollimi i pranisë së mbretërshës dhe aktivitetin e saj; Vëzhgimi i gjendjes dhe sasinë e ushqimit të ruajtur; Monitorimi i numrit të bletëve dhe sjelljen e tyre për të identifikuar shenjat e çrregullimeve ose sëmundjeve; Sigurimi që kosheret të janë të pastra dhe të ajrosura mirë).

2. Ushqimi i Bletëve

(Periudha me burime të bollshme, kur bletët mbledhin nektar dhe polen nga lulet; Në mungesë të burimeve natyrore – Sigurimi i ushqimeve alternative për të mbajtur koloninë të fortë; Gjatë dimrit, sigurimi që kosheret të kenë rezerva të mjaftueshme mjalti ose ushqim suplementar).

3. Parandalimi dhe trajtimi i sëmundjeve

(Parazitët e zakonshëm që mund të dëmtojnë koloninë, trajtimi bëhet me metoda natyrore ose kimike të aprovuara; Infeksionet që ndikon në tretjen e bletëve, trajtohet me higjienë të mirë dhe ushqim të balancuar; Sëmundjet bakteriale, mund të kontrollohen me inspektim të rregullt dhe pastrimin e kornizave të infektuara.

4. Mbrojtja nga kushtet klimatike

(Në verë, siguro ujë të freskët dhe hije për të mbrojtur bletët nga temperaturat e larta; Në dimër, izolo kosheret dhe siguro ushqim të mjaftueshëm për t'u mbrojtur nga uria dhe i ftohti.



Foto 4: Kujdesi dhe menaxhimi i bletëve

Këshilla praktike për ushqimin plotësues:

- **Mos përdor mjaltë nga bletë të sëmura** - mund të përhapë sëmundje në kosheret e shëndosha.
- **Mos jep shurup në ditë të ftohta** - rrezik i fermentimit dhe lagështisë në kosherë.
- **Vendos ushqimin afër folesë**, që bletët të kenë qasje pa shpenzuar energji.
- **Kontrollo rezervat në dhjetor dhe janar** - nëse rezervat bien poshtë 5–6 kg, jep brumë/ushqim për blete.

Përgatitje të tjera dimërore përveç ushqimit:

- **Ngushto hyrjen e kosheres** për të ruajtur nxehtësinë dhe mbrojtur nga minjtë.
- **Izolo kosheren** me materiale të ajroshme (jo plastike që mbledh lagështi).
- **Siguro ventilim të mirë**, për të shmangur formimin e lagështirës së dëmshme.
- **Hiq kornizat bosh** dhe lëre vetëm kornizat me bletë dhe ushqim.

Përfitimet shëndetësore të produkteve të bletarisë

Produktet e bletarisë janë burime natyrore me vlera të jashtëzakonshme për shëndetin e njeriut. Ato përmbajnë përbërës bioaktivë që ndihmojnë në forcimin e sistemit imunitar, luftimin e sëmundjeve dhe përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme, të cilat janë:

1. Mjalti - është një nga produktet më të njohura të bletarisë, i pasur me vitamina, minerale, antioksidantë dhe enzima natyrore. Përfitimet shëndetësore janë: forcon sistemin imunitar, ndihmon në shërimin e plagëve, përmirëson tretjen, lehtëson simptomat e ftohjes dhe kollës, jep energji natyrale.

2. Propolisi - është një substancë rrëshinore që bletët e mbledhin nga bimët dhe e përdorin për dezinfektimin e koshereve. Ka veti të fuqishme antibakteriale dhe antivirale. Përfitimet shëndetësore janë: Lufton bakteret, viruset dhe kërpudhat, përmirëson shëndetin oral, lehtëson simptomat e të ftohtit dhe gripit, mbron nga sëmundjet kronike.

3. Poleni i bletës - është një burim i pasur i proteinave, aminoacideve esenciale, vitaminave dhe mineraleve. Përfitimet shëndetësore janë: Rrit energjinë dhe qëndrueshmërinë fizike, forcon sistemin imunitar, përmirëson metabolizmin dhe tretjen, ul reaksionet alergjike.

4. Qumështi i bletës - është një substancë e prodhuar nga bletët punëtore për të ushqyer mbretëreshën e bletëve. Ka përbërje të pasur me proteina, vitamina dhe acide yndyrore të dobishme. Përfitimet shëndetësore janë: Përmirëson funksionin e trurit dhe kujtesën, ul stresin dhe lodhjen, përmirëson shëndetin e lëkurës, forcon shëndetin kardiovaskular.

5. Dylli i bletës - përdoret kryesisht në prodhimin e kozmetikës natyrale dhe produkteve farmaceutike. Përfitimet shëndetësore janë: Hidraton dhe mbron lëkurën, ndihmon në trajtimin e plagëve dhe djegieve, përdoret në trajtimin e alergjive dhe problemeve të frymëmarrjes.

Identifikimi i dëmtuesve dhe sëmundjeve të Bletëve

Bletët mund të preken nga dëmtues të ndryshëm dhe sëmundje që ndikojnë në shëndetin e kolonisë dhe produktivitetin e tyre. Identifikimi i hershëm dhe trajtimi adekuat janë thelbësorë për ruajtjen e një bletarie të shëndetshme.

Dëmtuesit kryesorë të Bletëve janë:

- a) Varroa destructor (Paraziti Varroa);
- b) Miza e vogël e kosherës (Aethina tumida);
- c) Gaforrja e dyllit (Galleria mellonella).

Sëmundjet kryesore të Bletëve janë:

- a) Sëmundja amerikane e huallit (American Foulbrood);
- b) Nosema (Sëmundja e zorrëve).

Për të pasur një bletari të shëndetshme, është thelbësore të identifikohen dëmtuesit dhe sëmundjet në fazat e hershme dhe të përdoren metodat e duhura për luftimin e tyre. Metodatat natyrore dhe biologjike janë gjithmonë të preferuara, ndërsa pesticidet duhet të përdoren vetëm kur është e nevojshme dhe sipas rregullave të sigurisë

Pesticidet për luftimin e dëmtuesve në bletari, është shumë e rëndësishme që pesticidet të përdoren me kujdes për të mos dëmtuar bletët. Ja disa pesticide të aprovuara për përdorim:

Pesticidi	Përdorimi	Efikasiteti	Masat e sigurisë
Acidi oksalik	Kundër varrosa	Efektiv në dozë të ulët	Duhet përdorur në temperatura të ulëta
Acidi formik	Kundër varroas dhe Nosemës	Efektiv, natyral	Mund të jetë toksik për bletët në doza të larta
Amitraz	Kundër varrosa	Shumë efektiv	Duhet përdorur vetëm sipas udhëzimeve
Ekstrakti natyral	Kundër varroas dhe gaforres së dyllit	Efektiv dhe natyral	Përdoret në pranverë dhe vjeshtë
Fumagilinë	Kundër Nosemës	Efektiv për trajtimin e infeksionit	Duhet përdorur vetëm kur është e nevojshme

Përfundimet

Bletaria është një sektor me potencial të madh për zhvillimin ekonomik dhe shëndetësor, sidomos për vendet si Kosova ku ka kushte të përshtatshme natyrore për këtë aktivitet.

Menaxhimi i bletëve për prodhim të qëndrueshëm kërkon një qasje të integruar që përfshin kujdesin për shëndetin e bletëve, mbrojtjen e mjedisit dhe optimizimin e prodhimit. Duke ndjekur praktikatat më të mira dhe duke u përshtatur me ndryshimet klimatike dhe kërkesat e tregut, bletarët mund të sigurojnë një industri të qëndrueshme dhe fitimprurëse.

Produktet e bletarisë janë burime natyrore me përfitime të shumta shëndetësore. Ato ndihmojnë në forcimin e sistemit imunitar, përmirësimin e tretjes, rritjen e energjisë dhe mbrojtjen e organizmit nga sëmundjet. Përfshirja e tyre në dietën e përditshme mund të ndihmojë në ruajtjen e një shëndeti të mirë dhe një jete më të gjatë.

Për më shumë informata ju lutem kontaktoni:



MBPZHR- Departamenti i Shërbimeve Këshillimore Teknike

Rr. "Ukshin Hoti" ndërtesa "Ramiz Sadiku", Nr.120

10000 Prishtinë

Tel : +383 38212338 ; +383 200 38 426

Tel/ fax: +383212 987

Kjo broshurë është përgatitur nga KDC, me Projektin "Zhvillimi i Zonave Rurale përmes avancimit të Shërbimeve Këshillimore", të financuar nga MBPZHR. Përgjegjësinë për përmbajtjen e broshurave e mban KDC.



**KOSOVA DEVELOPMENT CENTER
QENDRA KOSOVARE PËR ZHVILLIM**

Address: Dëshmoret e Linisë nr.135 Gjakovë-Kosovë
Tel: +383 38 724 499 Email: kdc-gjakov@yahoo.com
www.kdc-ks.org

